DORACAK PËR PËRDORIMIN E SHËRBIMEVE REGJISTRIMI I NOTAVE DHE REGJISTRIMI I KOLOKUIUMEVE NË KUADËR TË E-PROFFESOR

PRISHTINË

Doracak për përdorimin e Regjistrimit të Notave dhe Kolokuiumeve

Përmbajtja

1.	Regjistrimi i Notave	3
	1.1. Si të keni qasje në Regjistrimin e Notave	3
	1.2. Përdorimi i Regjistrimit të Notave	3
	1.3. Vendosja e notave	6
	1.4. Eskportimi	8
2.	Regjistrimi i Kolokuiumeve	9
	2.1. Si të keni qasje në Regjistrimin e Kolokuiumeve	9
	2.2. Përdorimi i Regjistrimit të Kolokuiumeve	9
	2.3. Vendosja e pikëve	10

1. Regjistrimi i Notave

Regjistrimi i Notave është shërbim i ri në kuadër të e-Professor. Përmes këtij moduli, mësimdhënësit do të mund të bëjnë regjistrimin e notave të provimit në mënyrë elektronike pas mbajtjes së provimit dhe ndryshimin e tyre pas mbajtjes së konsultimeve.

Po ashtu, profesorët në kuadër të këtij shërbimi kanë mundësi të shohin statistikat e përgjithshme të provimit të caktuar, eksportimin e tyre si dhe eksportimin e listës së studentëve. Eksportimi bëhet në formatin Excel.

1.1. Si të keni qasje në Regjistrimin e Notave

Në këtë shërbim profesorët kanë qasje përmes llogarive të tyre në e-Professor.

Kujdes:

Rekomandohet të keni fjalëkalime më të ndërlikuara për shkak të sigurisë sa më të madhe.

1.2. Përdorimi i Regjistrimit të Notave

Që të mund ta përdorni këtë shërbim, së pari duhet të qaseni në llogarinë tuaj në e-Professor. Në anën e majtë siç shihet në figurë, është shtuar një link i ri '**Vleresimet'** dhe pastaj në nënmenynë e saj, opsioni **'Regjistrimi i Notave'**.



Pasi të klikoni në atë link do të ju listohen të gjitha kampuset ku mbani mësim dhe ka paraqitje të provimeve, fakulteti dhe niveli i studimeve.

Për të zgjedhur fakultetin për të cilin dëshironi të regjistroni nota për afatin e caktuar, klikoni në linkun përkatës '**Vazhdo**' në anën e djathtë.

Ir	nfo! Afati i SHTATORIT Viti akademik 2015/2016											
	Ju lutem zgjedhni Fakultetin per te cilin deshironi te regjistroni Notat per afatin e Shtatorit !											
	Kampusi	Fakulteti	Niveli	Komanda								
	Prishtinë	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	Bachelor	Vazhdo								
	Prishtinë	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	Master	Vazhdo								

© 2016 - Universiteti AAB

Në këtë hap i gjeni të listuara drejtimet për fakultetin përkatës dhe vitin e studimeve. Vazhdoni më tej duke klikuar linkun '**Vazhdo**' për drejtimin që keni zgjedhur.

Info! Afati i SHTATORIT Viti akademik 2015/2016

Ju lutem zgjedhni drejtimin per te cilin deshironi te regjistroni Notat per afatin e Shtatorit !

Drejtimi	Lenda e	Komanda		
Inxhinieri Softuerike	Viti III	Vazhdo		
Telekomunikimi dhe Teknologjia e Info.	Viti III	Vazhdo		
Drejtimet e Sh. Kompjuterike	Viti I dhe II	Vazhdo		
Komunikimi në Rrjeta	Viti III	Vazhdo		
Mekatronika	Viti III	Vazhdo		

© 2016 - Universiteti AAB

Këtu do të shfaqen lëndët përkatëse të drejtimit të zgjedhur si dhe numri i studentëve që kanë paraqitur provimin në atë lëndë. Nëse numri i studentëve të paraqitur është 0, atëherë te kolona **'Regjistro'** do të shihni një ikonë të kuqe e cila ju ndalon të regjistroni nota për atë lëndë. Kjo shihet edhe në figurën më poshtë.

Info! Afati i DHJETORIT Viti akademik 2016/2017									
Ju lutem zgjedhni lëndën për të cilin dëshironi të regjistroni notat !									
Lenda	👤 Te paraqitur	Regjistro							
Historia e filmit dhe televizionit	0	0							

Përndryshe, nëse numri i studentëve të paraqitur është më i madh se 1 atëherë vazhdoni duke përcaktuar lëndën që dëshironi të regjistroni notat dhe klikoni linkun '**Regjistro**'.

Info! Afati i DHJETORIT Viti akademik 2016/2017									
Ju lutem zgjedhni lëndën për të cilin dëshironi të regjistroni notat !									
Lenda	👤 Te paraqitur	Regjistro							
Historia e filmit dhe televizionit	2	Regjistro							

Në këtë hap do të shfaqet faqja kryesore për regjistrimin e notave. Në pjesën e sipërme të dritares do të shihni informata rreth provimit si: emri i lëndës, data e provimit, numri total i studentëve që kanë paraqitur provimin, kurse në tabelë ai numër është i ndarë në bazë të gjeneratave të cilave u takojnë studentët.

Info! Afati i SHTATORIT Viti akademik 2015/2016

Sistemet e bazave të të dhënave : Total te paraqitur: 11 Data e Provimit: 20/09/2016

Gjenerata	Paraqiten	ECTS
2014/2015	8	6
2013/2014	3	6

Në pjesën e poshtme gjenden tre butona të vendosur horizontalisht.



Paraprakisht është i zgjedhur butoni '**Me Vijueshmeri'** ku janë të listuar të gjithë studentët që kanë vijuar ligjëratat dhe ekziston përqindja e evidencës së pjesëmarrjes së tyre në ligjërata. Kjo listë përmban këto informata rreth studentit:

- Studenti Emri dhe Mbiemri
- Gjenerata
- Indexi
- Statusi
- Vijueshmëria Pikët e vijueshmërisë
- Pikët e Kollokviumit I
- Pikët e Kollokviumit II
- Nota Fusha për vendosje të notës
- Opsionet për Abstenim ose Refuzim
- Gjendja Statusi nëse nota është e regjistruar ose jo në databazë
- Rezultati Preliminar ose Final

Me Vijueshmeri	Pa Vijueshmeri	Statistikat	
Me Vijushen	neri		

					Kol	Kol					
Studenti	Gjenerata	Indexi	Statusi	Vij	1	2	Nota	Abstenim	Refuzim	Gjendja	Rezultati

Shënim:

Preliminar – Nota pas rezultateve të provimit **Final** – Nota pas mbajtjes së konsultimeve

Në të djathtë të tij, gjendet butoni '**Pa Vijueshmeri'** ku listohen studentët që nuk kanë ndjekur ligjëratat. Këtu do të shihni fushat:

- Studenti Emri dhe Mbiemri
- Gjenerata
- Indexi
- Statusi
- Nota Fusha për vendosje të notës
- Opsionet për Abstenim ose Refuzim
- Gjendja Statusi nëse nota është e regjistruar ose jo në databazë
- Rezultati Preliminar ose Final

Me Vijueshmeri	Pa Vijueshmeri	Statistikat							
Pa Vijueshmeri									
Studenti	Gjenerata	Indexi	Statusi	Nota	Abstenim	Refuzim	Gjendja	Rezultati	

Doracak për përdorimin e Regjistrimit të Notave dhe Kolokuiumeve

Butoni i tretë është 'Statistikat' ku shfaqen këto kolona:

- Gjithsej të notuar Numri i studentëve të notuar
- Gjithsej të paraqitur Numri total i studentëve që kanë paraqitur provimin
- Abstenime Numri i abstenimeve
- Refuzime Numri i refuzimeve
- 5 Numri i notave 5
- 6 Numri i notave 6
- 7 Numri i notave 7
- 8 Numri i notave 8
- 9 Numri i notave 9
- 10 Numri i notave 10
- Kaluan % Përqindja e kalueshmërisë
- Nuk kaluan % Përqindja e jokalueshmërisë

Me Vijueshmeri	Pa Vijueshmeri	Statistika	at	Butoni për eksport të statistikave —								tim	Eksporto	
Gjithsej te notuar	Gjithsej te para	qitur	Abstenime	Refuzime	5	6	7	8	9	10	Kaluan %	Nuk k	aluan %	
11	11 0		0	0	0	11	0	0	0	0	100	0		

1.3. Vendosja e notave

Për të regjistruar notën për një student thjesht duhet të klikoni në fushën e notës për studentin e caktuar dhe shtypni njërën nga notat valide 5, 6, 7, 8, 9 ose 10. Automatikisht pas shtypjes së notës, në kolonën '**Gjendja**' ikona '**X**' ndryshon në '**V**', që tregon se nota është regjistruar në databazë me sukses.

Shënim:

Sistemi nuk lejon shtypjen e numrave më të vegjël se numri 5 dhe më të lartë se numri 10. Po ashtu, nuk lejon shtypjen e shkronjave apo karaktereve speciale.

• Nëse studenti nuk e ka kaluar provimin, shtypet nota 5 me ç'rast opsioni për Refuzim bllokohet. Në anën e djathtë të notës teksti mbetet '**Nuk kaloi!**'.

#	Studenti	Gjenerata	Indexi	Statusi	Vij	Kol 1	Kol 2	Nota	Abstenim	Refuzim	Gjendja	Rezultati
	Berat Ramizi	2014/2015	FSMT-5216/14	I Rregullt	4			5 Nuk ka	lloi!!		×	0

• Nëse studenti ka abstenuar, atëherë ofrohen dy mundësi:

I: Shtypni notën 5 dhe klikoni opsionin Abstenim me ç'rast teksti anash ndryshon në 'Abstenoi!'.

II: Ose keni mundësi drejtpërdrejt të klikoni opsionin 'Abstenoi' dhe automatikisht në fushën e notës vendoset nota 5, kurse teksti ndryshon në 'Abstenoi!'.

#	Studenti	Gjenerata	Indexi	Statusi	Vij	Kol 1	Kol 2	Nota		Abstenim	Refuzim	Gjendja	Rezultati
	Berat Ramizi	2014/2015	FSMT-5216/14	I Rregullt	4			5	Abstenoill	V		•	0

• Nëse studenti ka kaluar provimin shtypet nota përkatëse, me ç'rast opsioni për Abstenim bllokohet dhe statusi ndryshon në '**Kaloi!**'.

#	Studenti	Gjenerata	Indexi	Statusi	Vij	Kol 1	Kol 2	Nota		Abstenim	Refuzim	Gjendja	Rezultati
	Berat Ramizi	2014/2015	FSMT-5216/14	I Rregullt	4		(8	Kaloi!!			•	0

Nëse studenti ka refuzuar notën, atëherë duhet të klikoni opsionin Refuzim me ç'rast teksti ndryshon në '**Refuzoi!**' dhe llogaritet që studenti ka refuzuar notën.

#	Studenti	Gjenerata	Indexi	Statusi	Vij	Kol 1	Kol 2	Nota		Abstenim	Refuzim	Gjendja	Rezultati
	Berat Ramizi	2014/2015	FSMT-5216/14	I Rregullt	4			7	Refuzoi!!		1	×	0

Në rast se keni gabuar gjatë shtypjes së notave, ka mundësi të përmirësoni notën, prapë duke klikuar në fushën e notës dhe të vendosni notën e saktë. Ky ndryshim përcillet edhe në databazë. Kjo mundësi ofrohet si gjatë shtypjes së notave Preliminare, ashtu edhe gjatë vendosjes së notave Finale.

Pas vendosjes së Notave Finale duhet të klikoni në butonin '**Ruaj Rezultatin Final**' që shihet në figurë.

Ruaje Rezultatin Final

Në këtë rast hapet një dialog me një mesazh.

Kontakti	Tu	ng adn
INFO!	×	ECTS
		6
Nëse keni përfunduar me regjistrimin e notave dhe ky tani është Rezultati Final, ju konfirmoni duke klikuar mbi butoni PO!	lutemi	6
Ju njoftojmë se pas këtij veprimi nuk do të keni mundësi të bëni ndryshime në rezu	ltate!	
Po	Jo	
Statistikat		

Nëse klikoni 'Po', rezultati i notës nga 'Preliminar' ndryshon në 'Final'.



Nëse klikoni në këtë buton para përfundimit të të gjitha notave, atëherë shfaqet një mesazh i cili tregon se nuk mund ta kryeni këtë veprim pa i vendosur të gjitha notat.

к	ontakti	localhost:1501 says: Nuk i keni plotesuar te gjitha notat!	×	т	ung a
	INFC	Prevent this page from creating additional dialogs.		×	
mik 2	Nëse I konfirr Ju njot	OK tojmë se pas këtij veprimi nuk do të keni mundësi të bëni ndryshime në re	zult	utemi ate!	
s pa		Po		Jo	

Kujdes:

Mos klikoni në këtë buton nëse notat nuk janë përfundimtare, pasi që pas klikimit të këtij butoni mund vetëm t'i shihni notat e vendosura, pra **bllokohet** mundësia e ndryshimit të tyre.

Gjenerata	Indexi	Statusi	Vij	Kol 1	Kol 2	Nota	Abstenim	Refuzim	Gjendja
2015/2016	FKMP-8577/15	I Rregullt	7			10 Kaloi!!			•
2015/2016	FKMP-2999/15	I Rregullt	7	2		9 Kaloi!!			•

1.4. Eskportimi

Në kuadër të shërbimit Regjistrimi i Notave, ofrohet edhe mundësia e eksportimit të listave të Studentëve përmes butonit '**Eksporto**' si në figurë. Në klik të këtij butoni mund të zgjedhni se cilën listë të studentëve dëshironi të eksportoni.



Nëse njëra nga këto lista nuk ka asnjë student, atëherë klikimi i atij opsioni është i bllokuar.

Ekziston edhe mundësia e eksportimit të statistikave për provim. Kjo bëhet përmes klikimit të butonit '**Eksporto**' i cili gjendet te tabela e statistikave.

2. Regjistrimi i Kolokuiumeve

Portalit e-Professor tashmë i është shtuar edhe moduli i kolokuiumeve. Përmes këtij moduli, mësimdhënësit do të mund të bëjnë regjistrimin e vlerësimeve dhe pikëve në mënyrë elektronike.

2.1. Si të keni qasje në Regjistrimin e Kolokuiumeve

Në këtë shërbim profesorët kanë qasje përmes llogarive të tyre në e-Professor.

Kujdes:

Rekomandohet të keni fjalëkalime më të ndërlikuara për shkak të sigurisë sa më të madhe.

2.2. Përdorimi i Regjistrimit të Kolokuiumeve

Që të mund ta përdorni këtë shërbim, së pari duhet të qaseni në llogarinë tuaj në e-Professor. Në anën e majtë siç shihet në figurë, në nënmenynë e linkut 'Vleresimet' gjendet edhe linku 'Regjistrimi i kolokuiumeve'.



Në klik të këtij linku, do të shfaqet një tabelë ku janë të renditura kolokuiumet e mbajtura, së bashku me të dhënat e tjera si: lënda përkatëse, statusi i studentëve, drejtimi, fakulteti, kampusi dhe data kur është mbajtur.

Lista e kollokviumeve

Ju lutem zgjedhni fakultetin për të cilin dëshironi të regjistroni kolokiumin!

Kampusi	Fakulteti	Drejtimi	Lenda	Statusi	Data	Regjistro
Prishtinë	Fakulteti i Komunikimit Masiv	Drejtimet e Komunikimit Masiv	Historia e filmit dhe televizionit	I Rregulit	24/11/2016	Regjistro
Prishtinë	Fakulteti i Komunikimit Masiv	Komunikim Masiv - Produksion	Historia e filmit dhe televizionit	I Rregulit	24/11/2015	Regjistro
Prishtinë	Fakulteti i Komunikimit Masiv	Komunikim Masiv - Produksion	Historia e filmit dhe televizionit	Pa Shkëputje	30/12/2014	Regjistro
Prishtinë	Fakulteti i Komunikimit Masiv	Komunikim Masiv - Produksion	Historia e filmit dhe televizionit	I Rregullt	30/12/2014	Regjistro

Zgjedhni kolokuiumin e dëshiruar duke klikuar linkun 'Regjistro'.

Pas klikimit të linkut shfaqet njëra nga mundësitë:

1. Nëse është hera e parë që keni selektuar kolokuiumin e caktuar, atëherë duhet t'i jepni disa detaje rreth kolokuiumit, të cilat shihen në figurën e mëposhtme.



Pra, zgjedhni se a është kolokuiumi i parë ose i dytë, pikët maksimale që ka kolokuiumi dhe pikët e kalueshmërisë. Klikoni butonin **Shto** për t'i ruajtur të dhënat. Automatikisht, do të shfaqet tabela me të dhënat e sapo regjistruara.

Kolokviumi	Piket Max	Piket	
Kollofiumi 1	100	50	Regjistro

2. Nëse e keni përfunduar hapin e parë një herë, ju drejtpërdrejt do të shihni tabelën me detajet rreth kolokuiumit së bashku me linkun **Regjistro** në anën e djathtë.

2.3. Vendosja e pikëve

Në këtë hap do të shihni tabelën si në figurën më poshtë.

Lista e studentave

Studenti	Indeksi	Lenda	PIKET	
Agon Krasniqi	FKMP-0672/16	Historia e filmit dhe televizionit	0	×
Agron Demolli	FKMP-0016-13-R16/16	Historia e filmit dhe televizionit	0	×
Albert Rama	FKMP-6663/16	Historia e filmit dhe televizionit	5	~
Albi Reshitaj	FKMP-2447/16	Historia e filmit dhe televizionit	13	~
Ardit Neziri	FKMP-6136/16	Historia e filmit dhe televizionit	2	~
Argjend Sejdiu	FKMP-8978/16	Historia e filmit dhe televizionit	0	×

Për të vendosur pikët, vetëm shtypni pikët në kolonën **PIKET** dhe automatikisht pikët do të përcillen në databazë. Nëse studenti ka 0 pikë, atëherë ikona në të djathtë mbetet 'X', përndryshe ikona ndërron në '√'.

Për çdo paqartësi apo kërkesë për ndihmë teknike, ju lutemi mos hezitoni të kontaktoni Zyrën për Zhvillim Softuerik (SDO), objekti I, kati IV.

Mund të na shkruani edhe në emailin tonë zyrtar: helpdesk@aab-edu.net

Ju faleminderit që i përdorni shërbimet tona elektronike!